



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2024:103085

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06528173

K.Dh.Sh.II.nr.1962/2024

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë, në çështjen juridike të propozuesit të masës së sigurimit - paditësit “AM Sales” SH.P.K., me NUI: 811308924, me seli në Prizren, rruga “Tahir Sinani” p.n, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Vjosa Shkodra dhe Njomëza Zejnullahu, avokate nga Zyra e Avokatëve “Lex Bussiness”, me seli në Prishtinë, kundër kundërshtarit të sigurimit Dogana e Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, rruga “Rexhep Krasniqi”, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit - paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti i Përgjithshëm, KE.nr.283/24 të datës 31.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e propozuesit të masës së sigurimit - paditësit “AM Sales” SH.P.K., me NUI: 811308924, me seli në Prizren, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm KP.nr.283/24 i datës 31.07.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar propozimin e paditësit - propozuesit të masës së sigurimit propozuesit të masës së sigurimit - paditësit “AM Sales” SH.P.K., me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit Dogana e Republikës së Kosovës dhe të i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të bllokoj mallrat nga eksportuesit Eine Group SH.P.K., Shqipëri dhe Coca-Cola Bottling Shqipëria, të importuara nga “AM Sales” SH.P.K.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë propozuesi i masës së sigurimit – paditësi AM Sales Sh.P.K, përmes të autorizuarit Lex Business LLC, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave materiale, shkeljeve të dispozitave të procedurës dhe vërtetimit të gabuar e jo të plotë të gjendjes faktike me propozim që Dhomat e Shkallës së Dytë ta aprovojnë ankesën

si të bazuar, ta ndryshojnë aktvendimin e shkallës së parë dhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit ta aprovojë si të bazuar.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kundërshtari i masës së sigurimit.

Pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, aktvendimit të atakuar dhe shkresave të lëndës në pajtim me nenin 194 në lidhje me nenin 208 të LPK, Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale gjeti se:

- Ankesa e propozuesit të masës së sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Propozuesi i masës së sigurimit “AM Sales” SH.P.K., përmes të autorizuarës së tij, me datë 03.04.2024, ka paraqitur padë për kompensim dëmi dhe fitim të humbur me propozim për caktimin e masës së sigurimit kundër kundërshtarit të sigurimit Dogana e Republikës së Kosovës, me të cilën ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit dhe të ndalohet kundërshtari i sigurimit që të bllokoj mallrat nga eksportuesit Wine Group SH.P.K. Shqipëri dhe Coca – Cola Bottling Shqipëria të importuara nga “AM Sales” SH.P.K.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit të propozuesve të masës së sigurimit – paditësit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar propozimin e paditësit - propozuesit të masës së sigurimit “AM Sales” SH.P.K., me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit Dogana e Republikës së Kosovës dhe të i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të bllokoj mallrat nga eksportuesit Wine Group SH.P.K., Shqipëri dhe Coca-Cola Bottling Shqipëria, të importuara nga “AM Sales” SH.P.K.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale e pranojnë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Dhomat e Shkallës së Dytë vlerësojnë se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar masën e sigurimit me të cilën propozuesit kanë kërkuar që ndaj kundërshtarit të sigurimit - të paditurit të caktohet masa e sigurisë ashtu që t'i ndalohet dhe të i ndalohet kundërshtarit të sigurimit që të bllokoj mallrat nga eksportuesit Wine Group SH.P.K., Shqipëri dhe Coca-Cola Bottling Shqipëria, të importuara nga “AM Sales” SH.P.K.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale qëndrimin e tillë juridik e bazojnë në dispozitat e Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së me të cilat parashihet se:” *Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij , dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin*

apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Nisur nga fakti se në rastin konkret, paditësit kanë parashtruar propozim për sigurimin e kërkesëpadisë që i referohet një çështje nga e drejta e markave tregtare nën pretekstin se e paditura bën ndalimin e mallrave të paditësit në mënyrë të paligjshme bazuar në një vendim paraprak të gjykatës referuar ligjit të vjetër të markave tregtare. Sipas vlerësimit të kolegjit e paditura është organ administrativ e cila kompetencat e veta i ka të rregulluara me ligj të veçantë në domenin e së cilës gjykata nuk mund të ndërhyjë për veprime në të ardhmen. E rëndësishme në zgjidhjen e çështjes është fakti se veprimi respektivisht kryerja e bllokimit të mallrave siç pretendon paditësi që është objekt i masës së sigurisë është veprim që e paditura e kryen si veprim i saj administrativ. Ndonëse veprimi i tillë mund të mos jetë i ligjshëm, me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar masën. Kjo për faktin se veprimi i tillë administrativ nuk mund të ndalohej në procedurë kontestimore, por eventualisht pala duhet të ndjekë procedurat përkatëse – gjë që nuk nënkupton se veprimin dëmtues nuk mund ta kompensojë në rrugë gjyqësore. Megjithatë, Kolegji vlerëson se nuk ka tagër të veprohet sipas petitumit të kërkesës pasi që një gjë e tillë nënkupton ndalimin e autorizimeve të paditurës për të vepruar si organ administrativ, ligjshmëria e së cilit do të paragjykohej.

Për Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale tani për tani nuk mund të qëndrojnë si të bazuara pretendimet ankimore pasi që gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka refuzuar kërkesën nën pretekst se propozuesit të sigurimit nuk mund ti ofroj mbrojtje gjyqësore në kërkesën e paraqitur, meqenëse kërkesa është paraqitur për situata të cilat mund të ndodhin në të ardhmen, e për të cilat gjykata vlerëson se nuk mund të caktohet masa e sigurimit sepse qëllimi i caktimit të saj është siguri i kërkesës së paraqitur dhe e njëjta mund të caktohet dhe të ketë efektin e saj për kërkesën konkrete, ndërsa nuk mund të caktohet për situata apo ngjarje të ardhshme të pasigurta, e aq më pak për sigurimin e kërkesave të cilat palët mund të i paraqesin nën supozimin e shkeljeve që mund të paraqiten në të ardhmen.

Bazuar në të lartcekurat, Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim të drejtë kur ka refuzuar propozimin e propozuesve të masës së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit në këtë çështje kontestimore.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së dytë
Kom.Dh.shk.II.nr.1962/2024, me datë 18.11.2024

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova